

## 743 PIKËQASJA E NJËSUAR NË GJUHË DHE/APO SHKRIM TJETËR – EMËR/TITULL KONVECIONAL PËR TEKSTET LIGJORE DHE FETARE

Fusha përmban pikëqasjen e njësuar për emrin/titullin konvencional për tekstet ligjore dhe fetare, që janë në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër nga pikëqasja në fushën 243.

### Nënfushat & përsëritshmëria

| FUSHA/NËNFUSHA |  | PËRSËRITSHMËRIA |
|----------------|--|-----------------|
| 743            | Pikëqasja e njësuar në gjuhë dhe/apo shkrim tjetër – emër/titull konvencional për tekstet ligjore dhe fetare | r               |
|                | <b>a</b> <i>Elementi hyrës</i>   | nr              |
|                | <b>t</b> <i>Titulli konvencional</i>   | nr              |
|                | <b>2</b> <i>Kodi i sistemit</i>  | nr              |
|                | <b>8</b> <i>Gjuha e katalogimit</i>  | nr              |
|                | <b>9</b> <i>Gjuha e pjesës kryesore të pikëqasjes</i>  | nr              |

### Treguesit

| TREGUESI | VLERA | KUPTIMI   |
|----------|-------|---|
| 1        |       | <i>Nuk është i përcaktuar</i>   |
| 2        | 1     | <i>Mënyra e shënimit të emrit<br/>emër i shënuar sipas shtetit ose emrave të tjerë gjeografik</i> |
|          | 2     | <i>emër i shënuar sipas formës tjetër të emrit</i>  |

Vlera "1" e treguesit të dytë përdoret te emrat gjeografik nën juridiksion.

Vlera "2" e treguesit të dytë përdoret te emrat e kishës.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

Nënfushat **a** dhe **t** janë përshkruar tek fusha 243, ndërsa nënfusha 2, 8 dhe 9 në kapitullin *Nënfushat e kontrollit*.

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha përmban formën e emrit/titullit konvencional, që është përcaktuar në përputhje me rregullat kombëtare të katalogimit ose me sistemin e emërtimeve lëndore dhe është e lidhur me formën në fushën 243.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

- 243** *PIKËQASJA E NJËSUAR – EMËR/TITULL KONVENCIONAL PËR TEKSTET LIGJORE DHE FETARE*